

PROVIMI I SHTETIT, HISTORI

PROGRAMI PROFESIONAL

Programi profesional i provimit të shtetit për mësuesit e historisë, është hartuar në përputhje me urdhërat e udhëzimet e MASH për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Ai ka si qëllim të provojë nivelin e aftësisë dhe formimit profesional të mësuesëve të Historisë për shkollat e mesme. Në hartimin e programit janë mbajtur parasysh disa kritere: Programi sintetizon arritjet më të fundit të shkencës historike Brenda e jashtë vendit. Ai përmban një vëllim të domosdoshëm njohurish shkencore për profesionin e historianit. Si literaturë bazë për hartimin e tij kanë shërbyer vëllimet akademike të Historisë së Popullit Shqiptar dhe tekstet universitare të Historisë Botërore. Programi përbëhet nga dy pjesë. Qytetërimi botëror dhe Qytetërimi shqiptar. Vëllimi i njohurive historike për secilën lëndë përcaktohet nga vendi që zënë ato në shkollën tonë.

Programi trajton në mënyrë kronologjike e problemore zhvillimet historike botërore e kombëtare që nga kohët më të lashta. Ai trajton me përparësi arritjet e qytetimit bashkohore, sidomos ato të shek. XX. Vëllimi kryesor e zënë analizat për ngjarje a fenomene të historisë politike. Por, ai nuk lë pas dore edhe problemet ekonomike, sociale arsimore e kulturore. Mbi të gjitha theksi vihet tek analiza mbi konceptet historike. Programi nxit mendimin e pavarur të historianit për të mbajtur qëndrime objektive e reale mbi ngjarjet e dukuritë historike. Po ashtu ai ndihmon të kontrollohen aftësitë e profesionale të mësuesëve në vlerësimin e e trajtimin e figurave historike.

HISTORIA BOTËRORE

Objekti i njohjes historike

E vërteta historike

Raporti ndërmjet historianit dhe faktit historik

Individi dhe shoqëria në objektin e njohjes historike

Kohët e historisë

Lashtësia

Fillimet e shoqërisë njerëzore

Epoka e Neolitit

Premisat për lindjen e qytetimit të para

Qytetrimet e para

Qytetërimet e Mesopotamisë

Qytetërimi egjiptian i lashtësisë

Qytetërimi hitit

Qytetërimi fenikas

Qytetërimi hebraik i antikitetit

Qytetërimi persian

Qytetërimi i vjetër indian
Qytetërimi kinez i lashtësisë

Greqia e lashtë

Fillimet e qytetërimit të lashtë grek: (Qytetërimi Kreto - Mikenas)
Greqia në periudhën homerike (shek. XII - VIII)
Formimi i polisit si formë origjinale dhe specifike greke (shek. VIII - VI)
Kolonizimi i madh helen i shek. VIII - VI
Sparta në periudhën arkaike (shek. VIII - VI)
Procesi i formimit të shtetit në Athinë (shek. VIII - VI)
Luftërat greko - persiane (500 - 449)
Epoka e ndritur e demokracisë athinase
Lufta e Peloponezitetit (431 - 404)
Fatet historike të Greqisë dhe Maqedonia në epokën klasike (shek. V - IV)
Greqia dhe Maqedonia në epokën helenistike (shek. IV - I)
Arritjet e qytetërimit dhe kulturës greke në epokën arkaike, klasike dhe atë helenistike

Roma e lashtë

E t r u s k ë
Roma mbretërore
Republika romake
Zgjerimi i Republikës Romake dhe rënia e saj
Shndërrimi i Romës në superfuqi mesdhetare
Kultura romake në epokën republikane
Perandoria e hershme Romake
Shoqëria romake
Perandoria e vonë Romake
Krishterimi dhe universaliteti i tij
Rënia e Perandorisë Romake të Perëndimit
Kultura romake në epokën perandorake

Mesjeta

Fiset gjermanike dhe krijimi i mbretërive të tyre
Afirmimi i Krishterimit
Europa Karoline (shek. VIII - IX)
Ekonomia dhe shoqëria në Mesjetën e hershme (shek. V - X)
Perandoria Bizantine (*Krijimi, shkëlqimi dhe rënia e saj shek. IV - XV*)
Principatat dhe mbretëritë e Ballkanit (shek. VII - XIV)
Arabët dhe Islamizmi (shek. VI - XIII)
Ndryshimet në periferi të Europës (shek. IX - X)
Zhvillimi ekonomik e shoqëror në Europë gjatë shek. XI - XIII
Rilindja e jetës urbane
Zhvillimet politike dhe sociale në Europën Perëndimore gjatë shek. XI - XIII
Epoka e ideve të mëdha universale (*Papati e Perandoria Gjermane në shek. XI - XII*)
Perandoria Gjermane dhe Papati në shek. XII - XIII
Afirmimi i shteteve europiane në shek. XI - XIII

Kryqëzatat

Europa Lindore dhe zhvillimet përtej saj në shek. XII - XIII
Aspekte të jetës kulturore në shek. XI - XIII (Lindja e universiteteve)
Ekonomia dhe shoqëria në Mesjetën e vonë (shek. XIV - XV)
Procesi i forcimit të monarkive europiane në shek. XIV - XV
Gjermania dhe Italia në shek. XIV - XV
Rusia në shek. XII - XV
Papati dhe Kisha Katolike në Mesjetën e vonë (shek. XIV - XV)
Humanizmi dhe Rilindja e hershme europiane
Perandoria Osmane (1300 - 1500); Rënia e Ballkanit nën sundimin osman
Qytetërimi mesjetar në Indi, Kinë dhe Japoni
Qytetërimi i lashtë mesjetar në Amerikë; Amerika deri në prag të pushtimeve koloniale

Koha e re (Periudha moderne)

Shoqëria në fillimet e kohës së hershme moderne:

Rilindja e vonë Europiane
Reformacioni Protestant dhe katolik
Zbulimet e mëdha gjeografike
Kolonizimi dhe zhvendosjet në popullsinë botërore

Konsolidimi i monarkive absolutiste. Fillimet e krizës në qeverisje (1500 - 1789):

Monarkia spanjolle dhe sundimi i saj
Luftërat fetare dhe Lufta 30 - vjeçare
Monarkia absolute në Francë
Absolutizmi në vendet e tjera europiane
Rusia - Perandori e fuqishme
Konflikti mbret - parlament në Angli; Triumfi i parlamentit në Angli

Ndryshimet në jetën ekonomike dhe sociale në shek. XVII - XVIII:

Jeta ekonomike dhe sociale
Revolucioni i Parë Industrial

Idetë e reja dhe kombet e reja:

Iluminizmi
Krijimi i SHBA
Revolucioni francez i vitit 1789. Përmbysja e regjimit absolutist
Faza radikale e revolucionit francez. Kalimi në diktaturë
Europa Napoleonike
Pavarësia e Amerikës Latine
Kombet e reja të Amerikës Latine

Reaksioni dhe progresi në vitet 1815 - 1850:

Kongresi i Vjenës. Triumfi i Konservatorizmit
Progresi ekonomik
Zhvillimet kulturore e shkencore
Sfidat ndaj konservatorizmit

Revolucionet e vitit 1848 në Europë

Nacionalizmi dhe Realizmi (1850 - 1871):

Epoka e nacionalizmit dhe e realizmit (1850 - 1851)

Bashkimi i Italisë

Bashkimi i Gjermanisë

Ndryshimet në Perandorinë Austriake Lufta

civile dhe konsolidimi i SHBA

Perandoria Osmane dhe Ballkani në shek. XVI - XIX:

Perandoria Osmane si fuqi botërore drejt rënies (shek. XVI - XVII)

Lëvizjet përparimtare në Perandorinë Osmane

Vendet e Ballkanit në shek. XVI - XVII

Formimi dhe konsolidimi i shtetit modern grek

Formimi dhe forcimi i shtetit serb

Shteti i pavarur bullgar

Formimi i shtetit rumun

Vendet e tjera të Ballkanit: Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe çështja maqedonase

Fillimet e qeverisjes së demokracisë liberale:

Revolucioni i Dytë Industrial

Urbanizimi dhe problemet sociale

Zhvillimi i lidhjeve ekonomike dhe politike mbarëbotërore

Zhvillimet politike në Britaninë e Madhe

Franca - Republika III

Gjermania

Reformat në SHBA

Perandoria Ruse

Vendet aziatike dhe afrikane në kohët moderne:

Vendet e Lindjes. India në kohët moderne

Kina

Modernizimi i Japonisë

Ndarja e Afrikës

Qytetërimi në pragun e shek. XX:

Arritjet në qytetërimin perëndimor

Sfidat ndaj qeverisjes demokratike e liberale dhe kërcënimi i stabilitetit

Koha e sotme (Periudha Bashkëkohore)

Fillimi i shek. XX. Arritjet në modernizimin ekonomik, social dhe në sistemin ekonomik

Lufta e Parë Botërore (1914 - 1918). Rrjedhjet e saj

Totalitarizmi Komunist

Totalitarizmi Fashist. Italia gjatë viteve 1920 - 1930

Totalitarizmi Nazist. Gjermania në vitet 1920 - 1930

Efektshmëria e sistemit të demokracisë liberale

Britania e Madhe në vitet 1918 - 1939
Franca gjatë viteve 1920 - 1930
Lufta e Dytë Botërore
Karakteristikat e përgjithshme të shndërrimeve politike, ekonomike e sociale (1945 - 1980)
Britania e Madhe 1945 - 1979
Franca në vitet 1945 - 1981
Gjermania në vitet 1949 - 1981
Italia në vitet 1945 - 1981
Suedia në vitet 1945 - 1981
Tranzicioni spanjoll
SHBA në vitet 1945 - 1981
Prirjet themelore të zhvillimeve në vitet 1980 - 1990 (thellimi e konsolidimi i shoqërisë pasindustriale; Globalizmi)
Britania e Madhe në vitet 1979 - 1999. Theçerizmi. Laburistët e rinj
Franca ndërmjet alternativave
ShBA në vitet 1981 - 1997. Reganizmi. Demokracia e re
Bashkimi Sovjetik në vitet 1945 - 1985
Vendet e Europës Lindore e Qendrore në vitet 1945 - 1985
Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik
Fundi i regjimeve komuniste në vendet e Europës Qendrore
Shkenca, kultura dhe artet pas Luftës së Dytë Botërore
Lufta e Ftohtë dhe pasojat e saj në arenën ndërkombëtare
Bashkimi European në vitet 1951 - 2000

HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR

1. Qytetërimi ilir.

Gjurmë të hershme të shoqërisë njerëzore. Paleoliti. Qytetërimi prehistorik në Shqipëri. Periudha musteriane. Epoka e mezolitit. Vendbanimet neolitike dhe lindja e degëve të ekonomisë. Veglat dhe format primitive të punimit të tokës. Gjinia, njësi e vetme shoqërore. Grupet etnokulturore neolitike. Rite e kulte të epokës neolitike. Organizimi fisnor patriarkal. Lindja e metalurgjisë së bronzit. Familja patriarkale monogame. Lindja e diferencimit shoqëror të popullsisë.

Teori rreth etnogenezës së ilirëve. Teza mbi zhvillimin e pandërprerë të kulturës iliroshqiptare. Të dhëna arkeologjike mbi procesin e formimit të etnosit ilir (mijëvjeçari II). Dyndjet indoevropiane të popujve. Trualli historik i ilirëve. Fiset më të rëndësishme ilire. Ilirët në kohën e hekurit (shek XI-V p.e.s). Vendbanimet. Lindja e pronës private. Federatat fisnore. Gjuha dhe grupet kulturore ilire gjate epokës së hekurit. Kolonitë helene në bregdetin ilir dhe organizimi i tyre..

Zhvillimi skllavopronar i ilirëve (shek V p.e.s). Lindja e shteteve ilire. Dëshmi të hershme mbi jetën qytetare ilire. Zhvillimi i ekonomisë ilire, Tregëtia e qarkullimi monetar. Formacionet e para shtetërore ilire (shek IV-335 p.e.s). Mbretëria ilirë e Bardhylit. Lulëzimi i qyteteve ilire. Koinoni; njësi administrative e qytetit ilir. Koinoni (Lidhja) i Molosëve (shek.V-IV p.e.s.). Aleanca (Symahia Epirote) Organizimi politik i shtetit të

Epirit. Shteti i Epirit gjatë sundimit të Pirros. Rënia e regjimit monarkik në Epir dhe lindja e Republikës (234-168 p.e.sonë). Karakteri i Lidhjes Epirote.

Forcimi i shtetit ilir. Teza mbi formimin e Mbretërisë Ardiane. Shkaqet e luftrave iliro-romake. Bazat për lindjen e shtetit dardan. Organizimi politik i mbretërisë dardane. Organizimi administrativ i Ilirisë gjatë shek. IV-VI (Iliriku). Qytetet ilire dhe institucionet municipale. Tiparet e krizës në provincat ilire. Kultura ilire në shekujt e parë të erës sonë. Qendresa ilire ndaj romanizimit.

2. Qytetërimi mesjetar

Mesjeta e hershme (shek V-X). Shqipëria dhe Bizanti. Përhapja e krishterimit. Organizimi kishtar në trevat shqiptare. Dyndjet e popujve dhe ngulimet sllave në Ballkan. Përvijimi i hapsirës shqiptare në mesjetë. "Kultura e Komanit" . Marrëdhëniet e pronës në fshatin shqiptar (shek. VII-X). Regjimi i temave në Shqipëri.

Jeta politike në Shqipëri (shek.XII-XIII). Principata e Arbërit., Dukati i Durrësit, Despotati i Epirit. Anzhuinët dhe "Mbretëria e Arbërit". Gjendja kishtarë. Kristalizimi i fesë ortodokse. Prona feudale dhe detyrimet feudale. Zhvillimi urban dhe popullsia . Qeverisja e qyteteve. Formacionet shtetërore në shek.XIV-XV. Pricipatat. Përpjekjet e Balshajt për krijimin e një shteti të bashkuar. Shteti i Gjon Kastriotit. Zotërimet veneciane në Shqipëri. E drejta dhe jeta feudale; fisnkëria, kleri dhe roli i tyre. Kultura dhe mënyra e jetesës. Kalimi nga ilirishtja në shqipen e lashtë (arbërishtja). Dokumentet e para të shqipes së shkruar. Letërsia, arsimit, artet figurative dhe piktura mesjetare.

Pushtimet e para osmane në Shqipëri. Regjimi feudal ushtarak. Sistemi i timarit. Fillimi i luftës antiosmane. Rimëkëmbja e shtetit të Kastriotëve. Skënderbeu. Kryngritja çlirimtare e vitit 1443. Beslidhja shqiptare e Lezhës (2 mars 1443). Skënderbeu në konflikt me Venetikon dhe marrëveshja e paqes. Betejat kryesore të ushtrisë shqiptare gjatë viteve '50. Formimi i shtetit të bashkuar shqiptar. Forcimi i pushtetit të Skënderbeut. Marrëdhëniet nderkombëtare të Skënderbeut. Betejat shqiptare-osamne të viteve '60. Rëndësia e epokës së Skënderbeut.

Tokat shqiptare gjatë shek XVI-XVIII. Sistemi i timarit. Ndarja administrative. Detyrimet e fshatarësisë shqiptare. Organizimi autonom i krahinave malore. Shturja e sistemit të timarit. Lindja e çifligjeve. Marrëdhëniet çifligare. Rritja e qyteteve dhe regjimi esnafeve. Kuvendet shqiptare. Kuvendet ndërballkanike. Depërtimi i islam dhe faktorët e islamizimit në Shqipëri. Sektet islamike. Bektashizmi. Gjendja kishtarë në trojet shqiptare.

Pashallëqet shqiptare (1771-1831). Anarkia feudale dhe përpjekjet për kapërcimin e saj. Paria (oxhaqet) dhe lufta e saj për pushtet. Pashallëku i Shkodrës. Qendresa e Mahmut pashë Bushatliut. Qeverisja e Ibrahim Pashë Bushatliut dhe rënia e pashallëkut të Shkodrës. Lufta për pushtet në Shqipërinë e Jugore. Pashallëku i Janinës (1787). Ali pashë Tepelena. Shtetirja dhe organizimi i brendshëm i pashallëkut. Shembja dhe karakteri i pashallëkut të Janinës. Arkitektura në shek. XV-XVIII.

3. Rilindja Kombëtare

Rilindja kombëtare; programi politik dhe karakteri demokratik i saj. Iluminizmi. Periodizimi i lëvizjes kombëtare. Trojet shqiptare gjatë shek.XIX. Ndryshimet administrative; vilajetet. Ekonomia qytetare; shturja e esnafeve, manufakturat e fabrikat e

para. Marrëdhëniet agrare. Kriza e pronës çifligare. Depërtimi i ekonomisë së tregut dhe lindja e borgjezisë agrare.

Fillimet e lëvizjes kombëtare. Pasojat e reformave centralizuese osmane. Fillimet e ideologjisë e kulturës kombëtare. Tiparet e reja të lëvizjes kundërosmane. Kryengritjet e viteve '30-'40. Ideologët e parë. Naum Veqilharxhi. Kriza Lindore dhe Shqipëria. Pasojat e reformave të Tanzimatit. Mendimi politik e kultura kombëtare në vitet '50-'70 të shek. XIX. Z. Jubani, Th. Mitko. Shoqëritë kulturore. Çështja e alfabetit të gjuhës shqipe. Roli i ideologëve të lëvizjes kombëtare, N.Veqilharxhi, K. Kristoforidhi, H.Tahsimi, K.Hoxhi, P.Sotiri, P.N. Luarasi, etj. Lëvizja letrare dhe botimet shkencore. Fryma patriotike në veprat e intelektualëve arbëreshë (De Rada, Serembe etj.)

Shqipëria në fillim të Krizës Lindore. Pasojat e reformave të Tanzimatit. Komiteti i Janinës dhe projekti i kryengritjes antiosmane. Platforma politike e Komitetit të Stambollit. Shqipëria dhe Traktati i Shën Stefanit (3 mars 1878). Rrymat politike në lëvizjen kombëtare. Mendimi politik i Abdyl Frashërit. Lidhja e Prizërenit (10 qershor 1878). Kanuni dhe Urdhëresa. Shqipëria dhe Kongresi i Berlinit. Kuvendi i Dibrës (1 nëntor 1878). Lëvizja kundër administratës osmane. Konferenca e Berlinit (qershor 1880) dhe çështja kombëtare. Kuvendi i Gjirokastrës (23 korrik 1880). Kuvendi i Dibrës (20 tetor 1880). Mendimi politik, filozofik e shoqëror i Lidhjes së Prizërenit. Shoqëria e Stambollit (1879). Lufta për realizimin e autonomisë. Qeveria e përkohëshme dhe shtypja e Lidhjes së prizërenit.

Gjendja politike pas Lidhjes së Prizërenit. Shqipëria në politikën e Fuqive të Mëdha e të shteteve ballkanike. Organizimi dhe veprimtaria e diasporës shqiptare. Çelja e shkollës kombëtare të Korçës. Kërkesat për autonominë e Shqipërisë (1896). Beslidhja Shqiptare e vitit 1897. Lidhja Shqiptare e Pejës (23 janar 1899). Shtrirja e Lidhjes në treva të tjera shqiptare. Mendimi politik i rilindësve; S.Frashëri, I.Qemali, P.Vasa, S.Frashëri, N. Frashëri, etj. Lëvrimi i gjuhës shqipe dhe shkrimit shqip. Shtypi, letrësia, artet, etj.

Revolucioni i turqve të rinj (1908) dhe shqiptarët. Kuvendi i Ferizajt (korrik 1908). Klubet kombëtare. Çelja e shkollave shqipe. Kongresi i Manastirit (nëntor 1908). Kongresi i Dibrës (korrik 1909), Kongresi i Elbasanit (shtator 1909). Qëndresa shqiptare ndaj reaksionit xhonturk. Fillimi i kryengritjes së vitit 1910. Beteja e Kaçanikut. Qëndrimi i shteteve ballkanike. Kryengritja e Kosovës dhe Fuqitë e Mëdha. Kryengritja në Malësinë e Madhe (1911). Momerandumi i Greçës (23 qershor 1911) dhe jehona e tij.

Acarimi i gjendjes politike. Mbledhja e Taksimit (janar 1912). Hasan Prishtina. Dështimi i reformave xhonturke. Shpërthimi i kryengritjes (1912) dhe shndërrimi në kryengritje të përgjithëshme. Çlirimi i territoreve të Kosovës. Marrëveshja shqiptaro-turke. Bisedimet shqiptaro-turke. Qëndrimi i Fuqive të Mëdha. Aleanca ballkanike. Lufta e Parë Ballkanike. Shpallja e Pavarësisë dhe rëndësia historike e saj.

4. Periudha e Pavarësisë (1912-1939)

Kuvendi Kombëtar i Vlorës (28 nëntor-7dhjetor 1912). Qeveria e Ismail Qemalit. Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Vendimet e 17 dhjetorit 1912 dhe cungimi i kufijve të shtetit shqiptar. Statusi politik i Shqipërisë. Qëndrimi i Fuqive të Mëdha dhe i Portës së Lartë. Shteti i Pavarur Shqiptar. Lufta ndaj trupave pushtuese të shteteve fqinje. Veprimtaria e qeverisë së Vlorës. Lëvizja separatiste e Esat Toptanit. "Pleqësia e Shqipërisë së Mesme (12 tetor 1913)".

Regjimi i Vilhelm Vidit në Shqipëri (7 mars-3 shtator 1914). Caktimi i kufijve politik te shtetit shqiptar. Komisioni Kombëtar i Kontrollit (KNK). Aleanca turko- bullgare dhe Shqipëria. Dorëheqja e I.Qemalit. Kalimi i pushtetit në duart e KNK-ës. Qeveria e Princ Vidit. Statuti organik i Principatës së Shqipërisë (14 prill 1914). Lëvizja vorio-epirote dhe Protokollit i Korfuzit (17 maj 1914). Kryengritja e Shqipërisë së Mesme. Shpërthimi i Luftës Parë Botërore dhe pasojat e saj. Shqipëria në Traktatin e Fshehtë të Londrës (26 prill 1915). Regjimi i pushtimit. Protokollit franko-shqiptar për krijimin e "krahinës autonome" të Korçës (10 dhjetor 1916) Proklamata italiane e 3 qershorit 1917. Gjendja e Shqipërisë në mbarim të Luftës.

Programi politik i Lëvizjes Kombëtare. Kongresi i Durrësit (25 dhjetor 1918) dhe formimi i qeverisë së përkohëshme. Konferenca e Paqes e Parisit (18 janar 1919) dhe qëndrimi i delegacionit shqiptar. Rritja e lëvizjes kombëtare. Kongresi i Lushnjës (21-31 janar 1920). Qeveria e S. Delvinës. Dështimi i bisedimeve me Italinë. Lufta e Vlorës (5 qershor-2 gusht 1920). Ndërhyjra e diplomacisë ndërkombëtare. Rinjohja ndërkombëtare e Pavarësisë. Shqipëria në Lidhjen e Kombeve. Zgjedhjet parlamentare (1921). Lëvizja e marsit 1922. Zgjerimi i Statutit të Lushnjës. Ngritja e institucioneve fetare. Lëvizjet fshatare për reformën e tokës. Federata "Atdheu" dhe Shoqëria "Bashkimi".

Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese (vjesht 1923). Fitorja e Ahmet Zogut. Kryengritja e armatosur e qershorit 1924. Qeveria e Fan S Nolit. Shtypja e revolucionit të qershorit dhe shkaqet e dështimit të qeverisë së Nolit. Ndërhyjra ushtarake e jashtme.

Rivendisja e regjimit republikan të Ahmet Zogut (6 janar 1925). Triumfi i Legalitetit. Shpallja e Republikës. Statuti dhe institucionet republikane. Oragizimi politik, administrativ e gjyqësor i vendit. Afrimi i Zogut me Italinë dhe konçensionet në të mirë të saj. Paktet italo-shqiptare të Tiranës (1926,1927). Acarimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë. Lëvizjet antiqeveritare në vitet 1925-1928. Veprimtaria e grupeve politike në mërgim. Shoqëritë e para punëtore në Shqipëri.

Shpallja e monarkisë (1928). Statuti e institutet mbretërore. Pasojat e krizës ekonomike botrore në Shqipëri (1929-1933). Reformat e Mbretit Zogu I: Reforma legjislativë. Politika e jashtme e qeverisë së Zogut. Kriza e marrëdhënieve italo-shqiptare (1931-1935). Lëvizjet shoqërore e politike të viteve '30. Grupet komuniste. Organizata e fshehtë e Vlorës (1932). Kryengritja e Fierit (gusht 1935). Komiteti i Çlirimit Nacional (KÇN). Kultura shqiptare në vitet '20-'30. Mendimi filozofik, sociologjik e politik. Idetë demokratike. Krijimtaria letrare e artistike. F.Noli, Gj. Fishta, Migjeni, N.Bulka, L.Poradeci, M.Kuteli, E.Koliqi, etj. Lëvizja arsimore dhe veprimtaria botuese.

Përgatitja e agresionit fashist kundër Shqipërisë. Pasojat e krizës botërore. Qeveria liberale e Mehdi Frashërit (26 tetor 1935). Marrëveshjet italo-shqiptare të marsit 1936. Fuindi i "liberalizmit". Qeveria e Koço Kotës (nëntor 1936). Lëvizja e Delvinës (maj 1937). Përpjekjet e Romës për fashistizimin e jetës së vendit. Zgjerimi i ekspansionit ekonomik italian. Zbatimi i planit të G.Çianos për pushtimin e Shqipërisë. Ultimatumet e qeverisë së Romës. Kundërpërgjigja e mbretit Zog. Manifestimet popullore antifashiste. Zbarkimi i trupave fashiste italiane. Qëndresa e armatosur kundër fashizmit italian.

Kosova nën sundimin serb e malazez. Politika e spastrimit etnik. Shpronësimet dhe shpërnguljet e shqiptarëve (1913-1915). Pushtimi hungarez e bullgar (1916-1918). Organizimi administrativ i viseve shqiptare në vitet 1918-1919. Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (1918-1920). Lëvizja kaçake. Zona neutrale e Junikut. Lufta parlamentare. Partia e Xhemijetit (18 dhjetor 1918). Politika agrare e Beogradit në viset

shqiptare. Reforma agrare kolonizuese. Platforma e V.Çubriloviçit dhe Gj Perinës për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre. Prapambetja arsimore e kulturore e Kosovës.

Aneksimi i Çamërisë nga Greqia. Traktati i Lozanës (30 janar 1923) dhe shpërnguljet e popullsisë çame. Ngulimet shqiptare në vitet 1912-1925. Jeta e tyre kulturore e shoqërore. Ndhimesa e kolonive shqiptare në lëvizjen kombëtare dhe mbrojtjen e shtetit shqiptar. Emigracioni shqiptar në vitet 1925-1939. Organizimi i diasporës dhe rrjeti i shoqërive kulturore e arsimore.

5. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) 1939-1944.

Vendosja e regjimit të pushtimit italian. Institucionet politike dhe përpjekjet për fashistizimin e vendit. Marrëveshjet doganore dhe vërshimi i kapitalit italian. Propaganda fashiste. Fillimi i rezistencës antifashiste. Lëvizja punëtore, protestat e fshatarësisë, qëndresa në shkolla. Reagimi i diasporës shqiptare. Vatra dhe "Shqipëria e Lirë".

Organizimi i lëvizjes antifashiste të armatosur. Themelimi i Partisë Komuniste (PKSh). Roli i të dërguarëve jugosllav. Krijimi i çetave partizane. Konferenca e Pezës (16 shtator 1942). Vendimet dhe rëndësia e saj. Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar. Ushtra Nacionalçlirimtare dhe forcimi i pushtetit të Këshillave Antifashiste. Balli Kombëtar dhe programi i tij. Ngritja e strukturave ushtarake të Ballit, Çetat. Rrymat në gjirin e Ballit. Njohja e luftës së popullit shqiptar nga Fuqitë Aleate. Raportet e PK me BK. Veprimet luftarake në vitet 1942-1943. Mbledhja e Mukjes (1-3 gusht 1943) dhe vendimet e saj.

Kapitullimi i Italisë (8 shtator 1943). Agresioni nazist dhe qëndresa ndaj tij. Vendosja e regjimit të pushtimit gjerman dhe veçoritë e tij. Organet qeverisëse, Asambleja Kushtetuese. Regjenca dhe qeveria. Lëvizja e Legalitetit dhe forcat e tjera nacionaliste. Mësymja armike e dimrit 1943-1944. Kongresi i Përmetit (24 maj 1944). Operacioni armik i qershorit. Veprimet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Krijimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar (20 tetor 1944). Luftimet për çlirimin e Tiranës. Çlirimi i plotë i Shqipërisë. Rëndësia dhe karakteri i saj.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Fuqitë e Mëdha Aleate. Misionet angleze. Mbrojtja e gjenerali Dejvis. Bashkëpunimi dhe ndihma e Aleatëve. Bisedimet me Shtabin Aleat. Pikpamje mbi shndrimin e LANÇ në luftë civile. Lidhjet me Jugosllavinë. Qëndrimet mbi çështjen e Kosovës. Forcimi i ndërhyrjes jugosllave. Plenumi II (nëntor 1944).

Pushtimi fashist i Kosovës. Veçoritë e vështirësitë e organizimit të luftës antifashiste në Kosovë. Krijimi i Shtabit Kryesor. Lidhja e Dytë e Prizërenit (16-20 shtator 1943). Konferenca e Bujanit 31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944). Rezoluta e Bujanit dhe jehona e Konferencës. Njësitë partizane të Shqipërië në Kosovë.

Gjendja e Çamërisë në prag të luftës italo-greke. Rezistenca e armatosur çame kundër fashizmit. Spastrimi etnik në Çamëri. Bisedimet e Zervës me parinë çame. Sulmet dhe masakrat greke mbi popullsinë çame. Spekullime të historianëve grekë.

6. Regjimi komunist në Shqipëri 1944-1990.

Vendosja e regjimit komunist. Veçoritë e organizimit politik. Zgjedhjet për Asambleenë Kushtetuese (dhjetor 1945). Republika Popullore, formë regjimi tipike diktatoriale. Institucionet shtetërore. Organizatat e masave. Enver Hoxha. Programi i qeverisë komuniste. Reformat ekonomike. Likuidimi i kapitalit të huaj. Eliminimi i kapitalit industrial vendas. Fillimi i lëvizjes kooperativiste. Lufta politike në PKSh.

Kongresi I PKSh (1948). Kalimi në modelin socialist stalinist. Planifikimi, industrializimi dhe kolektivizimi socialist. Plani I e II pesëvjeçar. Lufta kundër analfabetizimit. Reforma Arsimore (17 gusht 1946). Çelja e shkollave të reja. Zgjerimi i arsimit të mesëm. Krijimi i arsimit të lartë. Univeriteti i Tiranës. Ngritja e institucioneve shkencore e kulturore.

Lufta politike e opozitës. Figurat kryesore nacionaliste. Rezistenca antikomuniste. Organizatat ilegale. Revoltat antikomuniste. Grupi i Deputetëve. Emigracioni politik shqiptar. Organizimi dhe orientimi i tij. Mit'hat Frashëri, Balli Kombëtar, Legaliteti.

Çështja e njohjes së qeverisë komuniste pas Luftës. Shqipëria dhe Fuqitë e Mëdha. Acarimi dhe prishja e marrëdhënieve me ShBA e Anglinë. Incidenti i Korfuzit. Forcimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe pasojat për vendin. Integrimi vendit në Bllokun Lindor. Aderimi në KNER (1949) e Traktatin e Varshavës (1955). Lulëzimi dhe prishja e marrëdhënieve me BS. Marrëdhëniet me vendet fqinj.

Veçoritë e regjimit komunist në vitet 60-,70. Politika në plan të parë. Lëvizjet politike e shoqërore. Reforma në administratë. Likujdimi i institucioneve fetare. Bunkerizimi. Vazhdimi i kursit të industrializimit. Përfundimi i kolektivizimit të bujqësisë. Likujdimi i pronës private dhe centralizimi shtetëror ekstrem. Reforma e re arsimore. Realizmi socialist në letërsi muzikë, art, etj. Kushtetuta e RPSSH (1976). Prishja e marrëdhënieve me Kinën. Izolimi i plotë i vendit.

Kriza e përgjithëshme e regjimit komunist. Kriza në kreun e shtetit. Ramiz Alia. Qeveria e A.Çarçanit. Vdekja e E.Hoxhës. Kursi i vazhdimësisë. Thellimi i krizës. Acarimi i situatës politike. Degjenerimi i tregut socialist. Rritja e pakënaqësisë popullore. Manifestimet e para antikomuniste. Lëvizja studentore dhe shpallja e pluralizmit politik. Krijimi i Partisë Demokratike. Zgjedhjet e para pluraliste (mars 1991).

7. Kosova dhe Çamëria pas Luftës.

Statusi juridik e kushtetues i Kosovës 1945-1948. Qendresa e popullsisë së Kosovës. Organizatat ilegale. Ndryshimi i kursit politik jugosllav. Kosova - koloni. Platformat politike diskriminuese e shkombëtarizuese. Ndryshimet në statusin juridik e kushtetues të Kosovës (1967-1974). Kushtetuta e KSA (1974). Lëvizja për zgjerimin dhe forcimin e autonomisë së Kosovës. Demonstratat e vitit 1981 dhe kërkesat për republikë.

Likujdimi i autonomisë së Kosovës (1989-1999). P[roçesi i diferencimit politik ekonomik e social. Platforma antishqiptare e Milosheviçit. Eliminimi i institucioneve legjitime të Kosovës. Lëvizja për demokraci. Krijimi i organeve të reja vetqeverisëse. LDK dhe Ibrahim Rugova. Dështimi i rrugës paqësore. Krijimi i UÇK-ës dhe lufta e armatosur. Çlirimi i Kosovës dhe roli i NATO-s. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe reformat për integrimin e saj në Evropë. Problemi çam pas Luftës. Diaspora shqiptare dhe lufta e saj kundër regjimit komunist.

8. Zhvillimet demokratike në Shqipëri 1990-2010.

Zgjedhjet e marsit 1992 dhe qeveria e parë antikomuniste. Sali Berisha. Programi i reformave për kalimin në ekonominë e tregut. Skemat piramidale dhe kriza e vitit 1997. Ardhja në fuqi e socialistëve (1997-2005). Sfidat e demokracisë shqiptare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Rikthimi i PD në pushtet (2005-2009). Integrimi evropian i Shqipërisë. Pranimi në NATO dhe nënshkrimi i MSA.

Literatura

- Ilira Çausi, *Metodologjia e Historisë*, Tiranë: SHBLU, 2003
Shaban Dervishi, *Greqia e Lashtë*, Tiranë: ALBAPRESS, 2001
Shaban Dervishi, *Qytetërimet e Para*, Tiranë: SHBLU, 2008

Shaban Dervishi, *Historia e Romës*, ribotim i dytë i ripunuar, Tiranë: SHBLU, 2010

Ilira N. Sulo, Llambro Filo, *Ngritja dhe rënia e civilizimeve*, Tiranë: Horizont, 2002

Thoma Murzaku, Abaz Mullai, Gëzim Sala, *Historia e Mesjetës*, (shek. V - XIII), Tiranë: SHBLU, 2003

Thoma Murzaku, Abaz Mullai, Gëzim Sala, Hysen Shabanaj, *Historia e Mesjetës*, (shek. XIV - XV), Tiranë: SHBLU, 2003

Thoma Murzaku, Abaz Mullai, *Historia e Ballkanit*, (nga antikiteti i vonë deri në shek. XVII), Tiranë: SHBLU, 2002

Thoma Murzaku, Kozeta Bego (Sala), *Historia e Bizantit*, Tiranë: SHBLU, 2011

Simon Lufi, *Historia e Mesjetës*, (shek. V - X), Shkodër: Rozofa 1, 2006

Ermal Baze, *Historia e Shoqërisë Evropiane në Mesjetë 500 - 1500*, Tiranë: Onufri 2007

Agron Gani, Gëzim Sala, Hysen Shabanaj, *Historia e Evropës*, (shek. XVI - XVIII) Tiranë: SHBLU, 2001

Romeo Gurakuqi, *Historia e Kohës së Re*, 2, (1775 - 1871), Shkodër: PHOENIXSHKODRA, 2001

Llambro Filo, *Historia e Sistemeve të Qeverisjes*, Tiranë: SHBLU, 2000

Andi Pinari, Llambro Filo, *Historia e Europës dhe SHBA*, (Koha e hershme moderne 1500 - 1815), Tiranë: Ideart, 2007

Petrit Nathanaili, *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga origjina deri më sot*, Tiranë: SHBLU, 2006

Petrit Nathanaili, *Historia e Botës moderne*, Tiranë: Ilar, 2007

Gëzim Sala, Llambro Filo, Ibrahim Gashi, *Historia Bashkëkohore* (Europa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë shek. XX), Tiranë: Albatros, 2009

Qytetërim botëror, X - XI, Tekst me zgjedhje për shkollat e mesme, Tiranë, 2011

Historia e Popullit Shqiptar I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë TOENA, 2002.

Historia e Popullit Shqiptar II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, TOENA, 2002.

Historia e Popullit Shqiptar III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, TOENA, 2007.

Historia e Popullit Shqiptar IV, Tiranë, TOENA, 2008

Historia e Shqiptarëve, XII, Tekst alternativ, Tiranë, 2011.

Historia e Shqiptarëve XII, Tekst më zgjedhje, Tiranë, 2011.

